



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2021

VENDIM

Nr. 365, datë 14.09.2021

PËR

**TRANSFERIMIN E PËRKOHSHËM ME PËLQIM NË GJYKATËN E RRETHIT
GJYQËSOR KAVAJË TË GJYQTARIT Z {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 1, të nenit 147 dhe në shkronjën “a”, pika 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në shkronjën “a”, pika 2, të nenit 61 dhe në shkronjën “c”, të nenit 86, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në pikën 1, të nenit 46, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në nenin 9, të Vendimit të tij nr. 23, datë 07.02.2019, “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”, i ndryshuar, pasi shqyrtoi kërkesat e gjyqtarëve që kanë dhënë pëlqimin për transferim të përkohshëm z. {...}, znj. Enkelejda Dalipi, znj. Entela Gjoni, znj. Adelaida Gjuzi, z. Florin Demollari dhe znj. Kostandina Kuro, mbi propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Transferimin e përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë të gjyqtarit z. {...}, për një periudhë deri në një vit, që mund të ndërpritet në rast të ndryshimit të rrethanave që kushtëzuan transferimin.
2. Efektet juridike të transferimit të përkohshëm fillojnë më datë 20.09.2021.
3. Gjyqtari {...} përjashtohet menjëherë nga procedurat e ndarjes së çështjeve gjyqësore në gjykatën ku ka caktimin e përhershëm, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec.
4. Gjyqtari {...} ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet gjyqësore që ka në gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, si gjyqtar i vetëm, kryetar ose anëtar i trupit gjykues, për të cilat ka filluar shqyrtimi gjyqësor, si dhe ato në çdo gjykatë tjetër i caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Çështjet e tjera gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec dorëzohen menjëherë prej tij.
5. Efektet financiare sipas këtij vendimi përballohen nga Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.
6. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit të transferuar përkohësisht z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR